

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gratë në drejtim: Jo vetëm çështje e barazisë gjinore, por forcë për sukses
ADRESA	https://a2news.com/shqiperia/socialle/grate-ne-drejtim-jo-vetem-ceshtje-e-barazise-gjinor-e-por-force-i1185848
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 13:58:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 13:37:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	38efdc79a5501258eb3ebecbb8864f00a20a35ae6b820df796fc48ed974f7e8
TEKSTI	785d7422aa4ab27e2b787bb1c0964c7a727d4a6ee3bf3de433d0655900475440
PAMJA	21721142a6d2340d56ec25ee82fc96e14b0887a0bd6f480c81635665140a2400

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	84671643621848ec4d3533a907641417b8033ff7be6bb4dfe2d1e726391f37f1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3a6c0ee943067392b175e06ac07a7b9996bbd474953cea4f063ab0e5555023da
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/84671643621848ec4d3533a907641417b8033ff7be6bb4dfe2d1e726391f37f1>


PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Gratë në drejtim: Jo vetëm çështje e barazisë gjinore, por forcë për sukses

Nga Ornela Joti
25 Shtator 2026, 15:37 | Sociale



Pjesëmarrja e grave në borde drejtuese nuk është thjesht dhe vetëm çështje e barazisë gjinore. Ajo konsiderohet një forcë shtytëse në suksesin e bizneseve.

Albana Vrioni, themeluesja dhe drejtuesja e Women on Boards Albania, tregon se si kompanitë në Shqipëri duhet të ndryshojnë kulturën e menaxhimit, proces që duhet të vijë nga rritja e përfaqësimit të grave në borde drejtuese.

"Unë jam vetë krijuese e një biznesi dhe kam ndjesinë dhe dëshirën për të kontrolluar biznesin tim. Por me rritjen e biznesit kam nevojë të kuptoj që unë nuk mund të bëj gjithçka dhe që mund të krijoj strukturat e nevojshme që vendimmarrja dhe perspektiva strategjike të jetë diverse dhe jo diverse në slogan, por diverse në kapacitet, sepse vetëm ashtu një bord ose një këshill vendimmarrës mund të marri vendimet më të shëndetshme për biznesin", tregon ajo për A2 CNN.

Në vitin e katërt të eventit për trajnimin e grave në drejtim u vë theksi tek sensibilizimi se si gratë të njohin dhe të zbatojnë të drejtat e tyre.

"Ne jemi goxha të mirë në ligje. Në fakt jemi goxha të mirë dhe në zbatim. Praktikë e fundit gjyqësore kanë ecur në këtë drejtim. Ajo që ne mungojmë është sensibilizimi, rëndësia e përfshirjes së të rinjve, grave, vajzave, djemve, të gjithëve në ato që ligji parashikon, në ato të drejta që ju njeh dhe në mënyrë se si duhet dhe mund t'i shfrytëzojnë", thotë Entela Memishaj, avokate.

Ledi Hysenji, drejtoresha e lejeve dhe standardeve në kompaninë Gener 2, tregon për rolin e rëndësishëm të vajzave dhe grave në kompaninë ku ajo punon.

"Jemi një numër shumë i madh femrash. Mund të themi që mund të jemi dhe numër të barabartë me drejtuesit meshkuj", tregon ajo. "Mendoj që femra është një katalizator shumë i mirë në marrjen e vendimeve".

Barazia gjinore është parakusht për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe ky proces konsiderohet po aq i rëndësishëm edhe për sektorin privat. **(A2 Televizion)**

TE FUNDIT

Del video e ekzekutimit të Artan Myrtajt në Sarandë

Mbërrin ambasadori amerikan, Eric Wendt dorëzon të shtunën letrat kredenciale te Presidenti

Prag përplasje në qiell. Avionët e Suedisë dhe Finlandës i zënë pritë atyre të Rusisë

Plagosje me armë zjarri në Tiranë

MË TË VIZITUARAT

Ftesa e Ramës për dialog me drejtësinë, Sadushi: Pagat i zgjidh Kushtetuesja,...

Plagosja me armë në Lezhë, në kërkim babë e bir. Sherri për pagesën e riparim...

Përgjaket Kievi, dronët rus shkatërrojnë ndërtesat civile

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Drama e fshatrave në Mallakastër, për dekada të harruar mes kodrave për 10 km rrugë



Asnjë qindarkë dëmshpërblim, fermerët e Maliqit pas përmbytjeve "mbeten në të thatë"



Zyra Përmbartimore Pogradec, dhomë për takimin e fëmijëve me prindër të divorcuar



Hipertensioni te fëmijët: Obeziteti dhe jeta pasive po plak para kohe enët e gjakut



Më shumë se sezoni i kaluar, Pogradeci me gjysmë milionë vizitorë në 8 muaj



"Karl Gega", modeli i parë demonstrues për teknologjitë miqësore me klimën në shkollat shqiptare

Latest Videos



Gratë në drejtim: Jo vetëm çështje e barazisë gjinore, por farsë për sukses



Mbërrin ambasadori amerikan, Eric Wendt dorëzon të aktunën letrat kredenciale te Presidenti



Prag përplasje në qiell. Avionët e Suedisë dhe Finlandës i zënë pritë atyre të Rusisë



Ftesa e Ramës për dialog me drejtësinë, Sadushi: Pagat i zgjidh Kushtetuesja, flasim për problemet e

Shqipëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi
Sociale
Kulturë
Moti

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë
Kronikë
Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim

Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë
Lumi i kokainës
Ditari ndërkombëtar
Zbulo
Imaginatë
Dëshmi



A2 CNN LOGO

Live TV

Rreth nesh Kushtet e Privatësisë Karriera Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësuar nga Mediodesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.